

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË
KOSOVË

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 08.02.2025

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKCAK- PIKËT E DHËNA
1. Pjesa A	20	
2. Pjesa B	20	
3. Problemi 1	15	
4. Problemi 2	10	
5. Problemi 3	15	
6. Problemi 4	5	
7. Problemi 5	5	
8. Problemi 6	5	
9. Problemi 7	5	

Total

100

Pjesa A: Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë)

Nga 2 pikë secila

1. Një faturë për shërbime të konsulencës për 25,000 Euro përfshin TVSH prej 18%. Sa është vlera e TVSH-së e rrumbullaksuar?
 - a) 4,500 Euro
 - b) 3,814 Euro**
 - c) 3,150 Euro
 - d) 2,800 Euro

2. Kompania "ProTech" pranon një faturë për 7,000 Euro nga furnitori i huaj për licenca softuerike dhe përdor metodën e ngarkesës së kundërt për TVSH. Sa është vlera e TVSH-së së llogaritur?
 - a) 1,260 Euro**
 - b) 1,400 Euro
 - c) 1,120 Euro
 - d) 980 Euro

3. Kompania "EnergyKosova" shiti inventore diellorë për 50,000 Euro (pa TVSH) dhe aplikoi një zbritje për klientë të rregullt prej 8%. Sa ishte shuma përfundimtare e shitjes me TVSH përfshirë zbritjen?
 - a) 53,640 Euro
 - b) 55,000 Euro
 - c) 52,920 Euro
 - d) 54,280 Euro**

4. Kompania "TechSavvy" realizoi fitim prej 300,000 Euro për vitin 2023. Sa është shuma e tatimit mbi fitimin sipas normës bazuar në TAK?
 - a) 25,000 Euro
 - b) 27,000 Euro
 - c) 30,000 Euro**
 - d) 33,000 Euro

5. Kompania "CleanFuture" ka blerë një automjet luksoz për 40,000 Euro përfshirë TVSH. Sa është vlera e TVSH-së së zbritshme?
 - a) 6,000 Euro
 - b) 3,051 Euro**
 - c) 7,200 Euro
 - d) 6102 Euro

6. Kompania "SmartSolution" realizoi një fitim para tatimit prej 500,000 Euro në vitin 2023. Sa është shuma e lejuar për sponsorizim për shoqëri kulturore për këtë kompani në këtë vit?

- a) 45,000 Euro
- b) 50,000 Euro
- c) 55,000 Euro
- d) 10,000 Euro**

7. Kompania "GreenLife" ka shpenzime për 10,000 Euro përfshirë TVSH me normën e reduktuar. Sa është shuma e TVSH-së së zbritshme?

- a) 741 Euro**
- b) 1,200 Euro
- c) 960 Euro
- d) 880 Euro

8. Nëse një punonjës ka të ardhura bruto mujore prej 800 Euro, sa është shuma e tatimit të pagës sipas Ligjit Nr. 08/L-142 me normat e reja tatimore?

- a) 48 Euro
- b) 40 Euro
- c) 47 Euro**
- d) 60 Euro

9. Nëse një kompani ka fitim para tatimit prej 600,000 Euro dhe aplikon një zbritje prej 30,000 Euro për donacione brenda normës së lejuar, sa është fitimi i tatueshëm?

- a) 570,000 Euro**
- b) 540,000 Euro
- c) 560,000 Euro
- d) 550,000 Euro

10. Nëse një kompani ka një politikë zhvlerësimi prej 12% për makineri me vlerë fillestare 60,000 Euro, sa do të jetë deferenca e zhvlerësimi për vitin e parë sipas normës së zhvlerësimit tatimore?

- a) 7,200 Euro
- b) 4,200 Euro**
- c) 7,500 Euro
- d) 6,800 Euro

Pjesa B. Pyetjet “E saktë/ E pasaktë”

Nga 1 pikë secila

1. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, një Shoqëri Tregtare mund të themelohet si biznes individual, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare.

Saktë

Pasaktë

2. Shoqëritë tregtare janë të detyruara të regjistrohen vetëm në qytetet ku zhvillojnë aktivitetet e tyre ekonomike.

Saktë

Pasaktë

3. Dega e një Shoqërie të Huaj Tregtare në Kosovë duhet të regjistrohet në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Saktë

Pasaktë

4. Bazuar në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Pasqyrat vjetore financiare të një shoqërie tregtare të madhe, duhet të përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Saktë

Pasaktë

5. Të gjitha shoqëritë tregtare në Kosovë janë të obliguara të mbajnë librat kryesorë dhe regjistrat kontabël për një periudhë të paktën 10 vjet.

Saktë

Pasaktë

6. Komiteti i auditimit i shoqërive me interes publik duhet të përbëhet nga drejtorë ekzekutivë me përvojë të konsiderueshme në fushën e kontabilitetit dhe financave.

Saktë

Pasaktë

7. Sipas Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore çdo person që i nënshtrohet ndonjë lloj tatimi të administruar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) duhet të regjistrohet në ATK dhe të pajiset me një numër fiskal para se të angazhohet në veprimtari ekonomike.

Saktë

Pasaktë

8. Sipas Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, një kompani me rastin e punësimit të një punonjësi është e detyruar të lajmërojë ATK-në një ditë para se të fillojë punën e punësuarit.

Saktë

Pasaktë

9. Bazuar në Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore, pasuria e një tatimpaguesi mund të konfiskohet nga ATK për të siguruar pagesën e një tatimi të papaguar.

Saktë

Pasaktë

10. Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore i jep të drejtë ATK-së të bëjë vizita pa njoftim paraprak për të mbledhur detyrimet tatimore dhe për të verifikuar përmbushjen e ligjeve tatimore.

Saktë

Pasaktë

11. Bazuar në Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore, tatimpaguesi mund të çregjistrohet nga ATK vetëm nëse ka deklaruar dhe paguar të gjitha detyrimet tatimore të tij.

Saktë

Pasaktë

12. Sipas Ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat Personale, pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi pensionet në Kosovë nga Trusti Pensional, janë të ardhura të lira nga tatimi sipas këtij ligji.

Saktë

Pasaktë

13. Sipas Ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat Personale, të ardhurat nga interesat mbi depozitat bankare janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Saktë

Pasaktë

14. Sipas Ligjit në fuqi për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, vlerësimi i aseteve për qëllime tatimore kryhet çdo 5 vjet për të gjitha kompanitë.

Saktë

Pasaktë

15. Sipas Ligjit të TVSH-së, kompanitë e regjistruara për TVSH janë të detyruara të aplikojnë ngarkesën e kundërt për shërbime të pranuar nga furnitorë të huaj.

Saktë

Pasaktë

16. Sipas Ligjit të TVSH-së, TVSH aplikohet vetëm për transaksionet e brendshme dhe jo për importet.

Saktë

Pasaktë

17. Bazuar në Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës, çdo punëdhënës në Kosovë është i obliguar që të kontribuojë një përqindje prej 5% të pagës së punonjësve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Saktë

Pasaktë

18. Sipas Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, kontributet për skemat pensionale plotësuese individuale janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në Kosovë.

Saktë

Pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës në Kosovë, punëdhënësi është i detyruar të lajmërojë të punësuarin në Administratën Tatimore të Kosovës dhe institucionet që menaxhojnë skemat e detyrueshme pensionale brenda një afati të caktuar pas fillimit të marrëdhënies së punës.

Saktë

Pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës në Kosovë, në rast të ndërrimit të punëdhënësit, kontrata e punës së punonjësit përfundon automatikisht dhe nuk bartet te punëdhënësi i ri.

Saktë

Pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

15 pikë

Kompania **UrbanBuild Sh.A.** ka filluar një projekt për ndërtimin e një kompleksi banesor me sipërfaqe totale për shitje prej 12,000 m². Ky kompleks përbëhet tërësisht nga ambiente banimi dhe projekti ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh. Kompania po zbaton dispozitat e Ligjit të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave për njohjen e të ardhurave dhe Kostos së Mallrave të Shitura (KMSH) për kontratat afatgjata të ndërtimit.

Të dhënat bazë të projektit:

- Sipërfaqja totale për shitje: 12,000 m²
- Kosto e parashikuar e projektit: 10,000,000 €
- Kosto e përditësuar në fund të projektit (viti III): 11,500,000 €
- Çmimi i shitjes për m²:? €/m²
- Të ardhura totale të planifikuara nga projekti:?

Të ardhurat e realizuara nga shitjet gjatë viteve:

1. Viti I:

- Sipërfaqja e shitur: 2000 m²
- Vlera totale e kontratave të shitjes: **2,400,000 €**
- Afatet e pagesave:
 - 30% paguar në vitin I,
 - 30% paguar në vitin II, pjesa tjetër paguhet në përfundim të projektit.

2. Viti II:

- Sipërfaqja e shitur: 4000 m²
- Vlera totale e kontratave të shitjes: **4,800,000 €**
- Afatet e pagesave:
 - 30% paguar në vitin II,
 - 30% në vitin III dhe pjesa tjetër në vitet në vazhdim.

3. Viti III:

- Sipërfaqja e shitur: 6000 m²
- Vlera totale e kontratave të shitjes: **7,200,000 €**
- Afatet e pagesave:
 - 30% paguar në vitin III,
 - Pjesa tjetër paguhet në vitet në vazhdim.

Kërkesat e detyrës:

- a. Kalkulo tatimin në fitim për **vitin e parë (Viti I)**
- b. Kalkulo tatimin në fitim për **vitin e dytë (Viti II)**
- c. Kalkulo tatimin në fitim për **vitin e tretë (Viti III)**
- d. Gjej dhe përlllogarite diferencën e KMSH-së për vitin I dhe II bazuar në koston e përditësuar të projektit, për të bërë korrigjimin në vitin III.

Zgjidhje

Viti	Pjesa	Siperfaqja eshitur	Te ardhura kontrata	Te ardhurat e vitit	KMSH	Fitimi	Tatimi ne fitim	KMSH perditesuar	Diferenca KMSH
I		2,000.00	2,400,000.00	720,000.00	500,000.00	220,000.00	22,000.00	575,000.00	75,000.00
II	Kontratat e vitit I	2,000.00	2,400,000.00	720,000.00	500,000.00	220,000.00	22,000.00	575,000.00	75,000.00
II	Kontratat e vitit II	4,000.00	4,800,000.00	1,440,000.00	1,000,000.00	440,000.00	44,000.00	1,150,000.00	150,000.00
II	Total		7,200,000.00	2,160,000.00	1,500,000.00	660,000.00	66,000.00	1,725,000.00	225,000.00
III	Total Akrual	6,000.00	11,520,000.00	11,520,000.00	9,500,000.00	2,020,000.00	202,000.00		

Viti I

- Sipërfaqja e shitur: 2000 m²
- Të ardhurat nga kontratat: 2,400,000 €
- Pagesa e marrë në kesh (30% e të ardhurave të kontratave):
- $30\% \times 2,400,000 = 720,000$ €
- KMSH (Kosto e Mallrave të Shitura) bazuar në koston e parashikuar të projektit: $2,0000 \times 833.333 = 1,666,667 \times 30\% = 500,000$
- Fitimi i realizuar: $720,000 - 500,000 = 220,000$ €
- Tatimi mbi fitimin (10% e fitimit): $10\% \times 220,000 = 22,000$ €
- KMSH bazuar në koston e përditësuar: $2,000 \times 958.33 = 1,916,666.67 \times 30\% = 575,000$ €
- Diferenca e KMSH-së për korrigjim në vitin III: $575,000 - 500,000 = 75,000$

Viti II

Në vitin e dytë, të ardhurat dhe KMSH janë ndarë në dy kategori:

1. Kontratat e vitit të parë që janë paguar në vitin e dytë
2. Kontratat e reja të vitit të dytë
3. Totalizimi i të dyjave

1. Kontratat e vitit të parë (të ardhura të njohura në vitin II)

- Të ardhurat nga kontratat: 2,400,000 €
- Pagesa e marrë në vitin II: $30\% \times 2,400,000 = 720,000$ €
- KMSH sipas kostos fillestare (10,000,000 €): $2,0000 \times 833.333 = 1,666,667 \times 30\% = 500,000$
- Fitimi bruto: $720,000 - 500,000 = 220,000$ €
- Tatimi mbi fitimin (10%): $10\% \times 220,000 = 22,000$ €
- KMSH sipas kostos së përditësuar (11,500,000 €):
 $2,000 \times 958.33 = 1,916,666.67 \times 30\% = 575,000$ €
- Diferenca e KMSH për korrigjim në vitin III: $575,000 - 500,000 = 75,000$ €

2. Kontratat e vitit të dytë

- Të ardhurat nga kontratat: 4,800,000 €
- Pagesa e marrë në vitin II: $30\% \times 4,800,000 = 1,440,000$ €
- KMSH sipas kostos fillestare (10,000,000 €):
 $4000 \times 833.333 = 3,333,333.33 \times 30\% = 1,000,000.00$ €
- Fitimi bruto: $1,440,000 - 1,000,000 = 440,000$ €
- Tatimi mbi fitimin (10%): $10\% \times 440,000 = 44,000$ €
- KMSH sipas kostos së përditësuar (11,500,000 €):
 $4000 \times 958.33 = 3,833.333.33 \times 30\% = 1,150,000.00$ €
- Diferenca e KMSH për korrigjim në vitin III: $1,150,000 - 1,000,000 = 150,000$ €

3. Totali për vitin e dytë

- Të ardhurat totale të njohura në vitin II: 2,160,000 €
- KMSH totale sipas kostos fillestare: $500,000 + 1,000,000 = 1,500,000$ €
- Fitimi total: $2,160,000 - 1,500,000 = 660,000$ €
- Tatimi mbi fitimin (10%): $10\% \times 660,000 = 66,000$ €
- KMSH totale sipas kostos së përditësuar: $575,000 + 1,150,000 = 1,725,000$ €

Viti III (Akrual)

- Të ardhurat totale që njihen (të gjitha kontratat e pashlyera nga vitet e kaluara + të vitit III): 11,520,000 €
- Te ardhurat e njohur në bazë akruale: 11,520,000 €
- KMSH sipas kostos së re: $9,200,000 \text{ €} + 300,000 \text{ € (difer.e kostove I+II)} = 9,500,000 \text{ €}$
- Fitimi: $11,520,000 - 9,500,000 = 2,020,000$ €
- Tatimi në fitim (10%): $2,020,000 \times 10\% = 202,000.00$

Problemi 2

10 pikë

Kompania "TechVision Hub" LLC, me seli në Prizren, është një kompani inovative që merret me zhvillimin e softuerëve dhe shitjen e pajisjeve teknologjike. Aktivitetet e kompanisë përfshijnë krijimin e aplikacioneve të personalizuar, tregtimin e pajisjeve inteligjente, dhe shërbime të mirëmbajtjes për bizneset lokale dhe ndërkombëtare. Kompania ka paraqitur të dhënat e mëposhtme financiare për periudhën 12-mujore të vitit 2023:

Të dhënat kryesore financiare:

1. Shitje softuerësh për klientë ndërkombëtarë: 150,000 € (pa TVSH, pasi eksportet janë të përjashtuara nga TVSH).
2. Shitje pajisjesh teknologjike për tregun vendor: 300,000 € (përfshirë TVSH 18%).
3. Shërbime të mirëmbajtjes dhe konsulencës për bizneset lokale: 50,000 € (përfshirë TVSH 8%).
4. Projekte softuerësh për institucione lokale: 120,000 € (pa TVSH).
5. Shpenzime për zhvillimin e produkteve të reja: 40,000 € (përfshirë 5,000 € shpenzime të kapitalizuara).
6. Shpenzime administrative dhe të menaxhimit: 25,000 € (pa TVSH).
7. Shpenzime marketingu dhe promovimi: 12,000 € (përfshirë TVSH 18%).
8. Blerje pajisjesh zyre dhe mirëmbajtje: 18,000 € (përfshirë TVSH 18%).
9. Stoqet e pajisjeve teknologjike në fillim të vitit: 80,000 € (pa TVSH).
10. Stoqet e pajisjeve teknologjike në fund të vitit: 100,000 € (pa TVSH).
11. Paga bruto për punonjësit: 70,000 € (përfshirë kontributet pensionale të punëdhënësit).
12. Import i pajisjeve teknologjike nga Kina: 220,000 € (përfshirë TVSH 18%).
13. Shpenzime për udhëtime dhe trajnime jashtë vendit: 15,000 € (pa TVSH).
14. Zhvlerësimi i pajisjeve teknologjike: 30,000 €.
15. Shpenzime për avokatë dhe konsulencë ligjore: 10,000 € (përfshirë TVSH 18%).
16. Shuma e arkëtueshme nga klientët për shërbime të kryera: 20,000 €.
17. Avancet e pranuar nga klientët për projekte softuerësh: 25,000 € (saldo më datë 31 dhjetor).
18. Tërheqje nga pronari për përdorim personal: 30,000 €.

Kërkesat:

- a) Llogaritni të ardhurat neto nga shitjet duke eliminuar TVSH dhe identifikoni të ardhurat e tatueshme për vitin 2023.
- b) Llogaritni Koston e Mallrave të Shitura (KMSH) për pajisjet teknologjike.
- c) Kalkuloni tatimin në fitim duke aplikuar normën tatimore prej 10% mbi fitimin e tatueshëm.

Zgjidhje**Te ardhurat**

Sh.nderkombetare	150,000.00
Sh.vendore	254,237.00
Sherbime lokale	46,296.00
Projekte per Inst	120,000.00
TOTAL	570,533.00

KMSH

stoqet ne fillim	80,000.00
stoqet e importuar nga Kina	186,440.00
stoqet ne fund	100,000.00
	166,440.00

Shpenzimet

Shpenz, e zhvillimit	35,000.00
Shpenzimet administrates	25,000.00
Shpenzimet e marketingut	10,169.00
Shpenzime e mirembajtjes	15,254.00
Pagat	70,000.00
Shpenzimet e udhetimit	15,000.00
Zhvleresimi	30,000.00
Shpenzime e konsulences	8,745.00
	209,168
TOTAL	375,608.00

Fitimi para tatimit	194,925.00
Tatimi	19,492.50

Problemi 3

15 pikë

Kompania "EcoFuture Solutions SH.P.K.", një kompani që promovon teknologjitë e gjelbra dhe menaxhimin e mbetjeve të riciklueshme, është duke përgatitur deklaratën e TVSH-së për muajin Tetor 2024. Kompania përballlet me një gamë të transaksioneve komplekse që përfshijnë shitje dhe blerje të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë transaksione të përjashtuara nga TVSH dhe aktivitete me norma të ndryshme tatimore.

Të dhënat financiare për muajin Maj 2024:

1. Shitje të produkteve të ricikluara brenda vendit me normë standarde (TVSH 18%): 50,000 € (pa TVSH).
2. Shitje të pajisjeve energjetike me normë të reduktuar (TVSH 8%): 20,000 € (pa TVSH).
3. Shitje shërbimesh të përjashtuara (pa të drejtë kreditimi): 10,000 €.
4. Shpenzime për shërbime këshillimore të pranuar nga një kompani zvicerane: 15,000 €
5. Import i pajisjeve për energji të rinovueshme: 60,000 € (përfshirë transportin).
6. Blerje të produkteve të ricikluara nga kompani vendore (normë standarde): 25,000 € (pa TVSH).
7. Shpenzime për trajnime dhe konferenca për promovimin e teknologjive të gjelbra: 5,000 € (normë standarde).
8. Blerje nga subjekte jo të tatueshme (blerje lokale): 4,000 €.
9. Notë kreditore e lëshuar për një gabim faturimi në shitjet e produkteve të ricikluara: 2,000 € (shuma e tatueshme, normë standarde).
10. Notë kreditore e pranuar për një pajisje defektive nga importi: 3,000 € (shuma e tatueshme).
11. Fatura për një borxh të keq të papaguar brenda 6 muajve: 450 € (shuma e tatueshme, normë standarde).

Koeficienti i zbritshem i perdorur për vitin 2024 është 90% .

Kërkesat:

- a) Përgatitni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së për muajin Tetor 2024, duke përfshirë të gjitha transaksionet e lartpërmendura.
- b) Llogaritni TVSH-në e llogaritur dhe të zbritshme për këtë periudhë.
- c) Tregoni se a ka pagesë ose kreditim për këtë muaj.

Zgjidhje

Shitjet	SHP pa te drejt kreditimi	10000		
	Shitjet vendore	50000	18%	9000
	Shitjet vendore norma e reduktuar	20000	8%	1600
	Ngarkesa e kundert	15000	18%	2700
	NK e pranuar	2700	18%	486
				13,786.00
Blerjet	Blerje pa tvsh	4000		
	Import i paisjeve	54000	18%	9720
	Blerje vendore	22500	18%	4050
	Blerje vendore	4500	18%	810
	NK e leshuar	2000	18%	360
	FBK	450	18%	81
				15,021.00
		-		
Kreditim		1,235.00		

Problemi 4

5 pikë

Kompania "GreenEnergy" SH.P.K., një biznes i dedikuar për promovimin e energjisë së rinovueshme dhe shitjen e pajisjeve të gjelbra, raportoi transaksione të ndryshme gjatë muajit Prill 2024. Të dhënat janë të mëposhtmet:

1. Blerje vendore me normë standarde (TVSH 18%): 10,000 € (pa TVSH).
2. Blerje vendore me normë të reduktuar (TVSH 8%): 6,000 € (pa TVSH).
3. Shitje vendore me normë standarde (TVSH 18%): 20,000 € (pa TVSH).
4. Shitje pajisjesh jashtë vendit (eksporte): 12,000 € (pa TVSH).
5. Shitje të përjashtuara pa të drejtë kreditimi: 7,000 € (pa TVSH).
6. Notë debiti e pranuar nga furnitorët për mallrat e blera (normë standarde): 5,000 € (pa TVSH).
7. Koeficienti për TVSH të zbritshme për këtë periudhë: 85% (bazuar në deklaratimet e vitit 2023).

Kërkesat:

- a) Llogaritni vlerën e TVSH-së së zbritshme për këtë muaj.
- b) Llogaritni vlerën e TVSH-së së llogaritur për këtë muaj.
- c) Llogaritni vlerën e TVSH-së së pagueshme për këtë muaj.

Zgjidhje

a)	TVSH e zbritshme	10,000.00	X 18%=	1,800.00	X 85%=	1,530.00
	TVSH e zbritshme	6,000.00	X 8%=	480	X 85%=	408.00
	TVSH-së së llogaritur	5,000.00	X 18%=	900	x 85%=	765.00
	TOTAL					2,703.00

b)	TVSH e llogaritur	20,000	X 18%=	3,600.00
----	-------------------	--------	--------	-----------------

c)	TVSH e pagushme	3,600 - 2,703 = 897.00
----	-----------------	-------------------------------

Problemi 5

5 pikë

Kompania "**FutureTech**" SH.P.K., një biznes inovativ në sektorin e teknologjisë së rinovueshme, ka bërë deklarin e TVSH-së për muajin **gusht 2024** më datë **25.09.2024**. Deklarata raportoi një obligim tatimor prej **2,800 €**. Sidoqoftë, për shkak të një keqmenaxhimi financiar, pagesa e këtij detyrimi u realizua më **20.11.2024**, duke tejkaluar afatin ligjor.

Kërkesa:

Bazuar ne dispozitat e Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore

- a) Sa janë gjobat dhe interesat e llogaritura për këtë vonesë në pagesë?
- b) Sa është shuma përfundimtare e pagueshme nëse kompania përfiton nga zbritja e sanksioneve?

Zgjidhje

- a) Mos deklarim ne kohe = 150
Interesi $2,800 \times 0.65\% \times 3 = 54,60$
- b) $2,800 + 45(150 \times 30\%) + 54.6 = 2,899.60$

Problemi 6

5 pikë

Kompania "**InnoTech L.L.C**", e themeluar në vitin **2018**, është një ndërmarrje që operon në sektorin e inovacioneve teknologjike në Kosovë. Në fund të vitit **2023**, kompania përballlet me sfida në menaxhimin e zhvlerësimit të aseteve, të cilat përfshijnë diferenca midis politikave kontabël dhe rregulloreve tatimore të vendit.

Politikat kontabël të kompanisë ndjekin standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, por rregulloret tatimore shpesh kërkojnë metoda dhe norma të ndryshme zhvlerësimi, duke krijuar një ndikim të drejtpërdrejtë në përlllogaritjen e të ardhurave të tatueshme dhe tatimeve.

Të dhënat për asetet e kompanisë:

1. Grupi I – Ndërtesa dhe Infrastrukturë:

Selia Kryesore e Operacioneve: **65,000 €**

Qendra për Kërkim dhe Zhvillim: **150,000 €**

2. Grupi II – Pajisje për Transport dhe Teknologji:

Automjet për Transport të Materialeve: **40,000 €**

Pajisje të Rrjetit për Sistemet e IT: **100,000 €** (*zhvlerësohen plotësisht gjatë vitit 2023 pasi kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre. Zhvlerësimi ishte i plote për vit).*

3. Grupi III – Makineri dhe Pajisje Industriale:

Makineri për Procesimin e Prototipeve: **90,000 €**

Robotikë për Prodhim të Automatizuar: **110,000 €**

Normat e zhvlerësimit sipas politikave kontabël:

- **Grupi I:** 4% (Metoda Lineare).
- **Grupi II:** 15% (Metoda Lineare).
- **Grupi III:** 12% (Metoda Lineare).

Normat e zhvlerësimit sipas ligjit tatimor:

- **Grupi I:** ?
- **Grupi II:** ?
- **Grupi III:** ?

Kërkesat:

1. Llogaritni zhvlerësimin tatimor për secilin aset duke përdorur normat përkatëse për çdo grup.
2. Krahasoni shpenzimet e zhvlerësimit kontabël dhe tatimor për të identifikuar diferencat.
3. Analizoni ndikimin e këtyre diferencave në të ardhurat e tatueshme dhe në detyrimet tatimore për vitin 2023.

Zgjidhje:

1. Zhvlerësimi kontabel

Grupi I - Ndërtesa dhe Infrastrukturë:

- o Selia Kryesore e Operacioneve: $65,000 \text{ €} \times 4\% = 2,600$
- o Qendra për Kërkim dhe Zhvillim: $150,000 \text{ €} \times 4\% = 6,000$

Grupi II - Pajisje për Transport dhe Teknologji:

- o Automjet për Transport të Materialeve: $40,000 \text{ €} \times 15\% = 6,000$
- o Pajisje të Rrjetit për Sistemet e IT: $100,000 \text{ €} / 6 \text{ VITE} = 16,666.67$

Grupi III - Makineri dhe Pajisje Industriale:

- o Makineri për Procesimin e Prototipeve: $90,000 \text{ €} \times 12\% = 10,800$
- o Robotikë për Prodhim të Automatizuar: $110,000 \text{ €} \times 12\% = 13,200$

Normat e zhvlerësimit sipas ligjit tatimor:

- Grupi I: 5% (Metoda Lineare)
- Grupi II: 20% (Metoda Lineare)
- Grupi III: 10% (Metoda Lineare)

Kërkesat:

1. Llogaritja e zhvlerësimit tatimor për secilin aset duke përdorur normat përkatëse për çdo grup:

Grupi I - Ndërtesa dhe Infrastrukturë:

- o Selia Kryesore e Operacioneve:
 - Vlera: 65,000 €
 - Norma e zhvlerësimit tatimor: 5%

- Zhvlerësimi tatimor vjetor: $65,000 \text{ €} * 5\% = 3,250 \text{ €}$
- o Qendra për Kërkim dhe Zhvillim:
 - Vlera: 150,000 €
 - Norma e zhvlerësimit tatimor: 5%
 - Zhvlerësimi tatimor vjetor: $150,000 \text{ €} * 5\% = 7,500 \text{ €}$

Grupi II – Pajisje për Transport dhe Teknologji:

- o Automjet për Transport të Materialeve:
 - Vlera: 40,000 €
 - Norma e zhvlerësimit tatimor: 20%
 - Zhvlerësimi tatimor vjetor: $40,000 \text{ €} * 20\% = 8,000 \text{ €}$
- o Pajisje të Rrjetit për Sistemet e IT:
 - Vlera: 100,000 €
 - Zhvlerësimi tatimor për vitin 2023: $100,000 \text{ €} \times 20\% = 20,000$

Grupi III – Makineri dhe Pajisje Industriale:

- o Makineri për Procesimin e Prototipeve:
 - Vlera: 90,000 €
 - Norma e zhvlerësimit tatimor: 10%
 - Zhvlerësimi tatimor vjetor: $90,000 \text{ €} * 10\% = 9,000 \text{ €}$
- o Robotikë për Prodhim të Automatizuar:
 - Vlera: 110,000 €
 - Norma e zhvlerësimit tatimor: 10%
 - Zhvlerësimi tatimor vjetor: $110,000 \text{ €} * 10\% = 11,000 \text{ €}$

2.

Aseti	Zhvleresimi Kontabel	Zhvleresimi Tatimor	Diferenca
Selia Kryesore e Operacioneve	2600	3250	650
Qendra per Kerkim dhe Zhvillim	6000	7500	1500
Automjet per Transport	6000	8000	2000
Pajisje te Rrjetit per Sistemet e IT	20,000	20000	0
Makineri per Procesimin e Prototipeve	10800	9000	-1800
Robotike per Prodhim te Automatizuar	13200	11000	-2200

3.Shpenzimet per qellime tatimore do te rriten per 150 Eur

Problemi 7

5 pikë

Kompania "TechSolve L.L.C" ka një staf prej 6 punonjësish me paga të ndryshme. Në muajin Shtator 2024, kompania është e detyruar të llogarisë pagat bruto dhe neto sipas ligjit të ri për tatimin në të ardhurat personale dhe kontributet pensionale në Kosovë, ku:

Stafi dhe të dhënat e pagave për muajin Shtator 2024:

1. Alketa: Paga bruto 380 €.
2. Besimi: Paga bruto 650 €.
3. Dorina: Paga bruto 900 €.
4. Emini: Paga bruto 1,200 €.
5. Fiona: Paga bruto 2,000 €.
6. Genci: Paga bruto 3,500 €, përfshirë një bonus prej 500 € në këtë muaj për performancë të lartë.

Kërkesat:

Përllogariten shpenzimet për paga të kompanisë për muajin Shtator 2024, duke përfshirë:

Kontributet pensionale të mbajtura nga paga bruto e punonjësve.

Tatimin në të ardhurat personale (TAP) për çdo punonjës.

Pagat neto për secilin punonjës.

Shpenzimet totale të punëdhënësit, duke përfshirë kontributet pensionale.

Zgjidhje

			Rroga Bruto	Sigurimi pensional				Rroga e tatushme	Tat. për pjesën e pagës mbi				Neto për		Punëdhënësi kryesor
					Punëtori	Punëdhësi	Gjithsej		80 - 250 €	250.01 - 450€	Mbi 450 €	Gjithsej	pagesë		
				%					0%	8%	10%	8 + 9			
Nr.	Emri dhe mbiemri	NIP		%					0%	8%	10%	8 + 9			
1	3	4	5	6	7	8	9	10	10	11		12	13	15	
1	Alketa		380.00	5%	19.00	19.00	38.00	361.00	0.00	8.88	0.00	8.88	352.12	Po	
2	Besimi		650.00	5%	32.50	32.50	65.00	617.50	0.00	16.00	16.75	32.75	584.75	Po	
3	Dorina		900.00	5%	45.00	45.00	90.00	855.00	0.00	16.00	40.50	56.50	798.50	Po	
4	Emini		1,200.00	5%	60.00	60.00	120.00	1,140.00	0.00	16.00	69.00	85.00	1,055.00	Po	
5	Fiona		2,000.00	5%	100.00	100.00	200.00	1,900.00	0.00	16.00	145.00	161.00	1,739.00	Po	
6	Genci		4,000.00	5%	200.00	200.00	400.00	3,800.00	0.00	16.00	335.00	351.00	3,449.00	Po	
		Gjithsej:	9,130.00		456.50	456.50	913.00	8,673.50	0.00	88.88	606.25	695.13	7,978.37		